



Republika e Kosovës

Komuna e Drenasit

Kuvendi i Komunës



02 Nr. 060/04-57896 dt. 05/12/ 2024

PROCESVERBALI

I mbledhjes së Komitetit për Politikë dhe Financa të mbajtur më **20.11.2024**, e cila filloj ne ora **10:00**.

Mbledhjen e kryesoi: Bekim Lestrani - kryesues.

Kryesuesi deklaroi të hapura punimet e mbledhjes së Komitetit për Politikë dhe Financa, ku të pranishëm ishin: Ramiz Lladrovci, Kryetar i Komunes, anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa: Hamit Kastrati (PDK), Malsore Cakiqi (PDK), Azemine Bujupi Gjoka (DD), Hamit Haxhiu (DD), Arbër Halilaj (GREEN), si dhe drejtor të drejtorive komunale, Florentina Elezi-Veliu (VV) mungoi.

Mbledhja do të këtë:

Rend dite:

1. Procesverbali i mbledhjes së Komitetit për Politikë dhe Financa i dt. 18.10.2024.
2. Propozim vendim për shfuqizimin e vendimit për transfer të mjeteve financiare subvencione dhe transfere me nr. 02-400/01-47954 dt. 30.09.2024.
3. Propozim vendim për shfuqizimin e vendimit për ndryshimin e emrit të projektit me nr. 02-400/01-46220 dt. 19.09.2024.
4. Të ndryshme.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Bekim Lestrani, pasi përshëndeti të pranishmit, deklaroi të hapura punimet e mbledhjes së Komitetit për Politikë dhe Financa, fjala e kryetarit .

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci- siç kemi biseduar edhe ne takimin e radhës lidhur me dhënien e pronave me negocim tash me nga katërmëdhjetë propozimet që ishin mbledhjen e kaluar që vendosem me diskutuar për me i bërë grupet parlamentare nëntëmbëdhjetë operator kanë shfaqë interes për marrjen e pronave në shfrytëzim, ligjshmëria e këtij vendimi ende nuk na është kthyer akoma edhe pse janë bërë 60 ditë, edhe pse i kemi shkruar shumë imella i kemi dërguar ministrisë po besoi që deri para mbledhjes do të na kthehet ligjshmëria do të ia propozoj grupeve parlamentare për një komision ku do të negociohet me këta operator që duan të investojnë në komunën tonë.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Bekim Lestrani, hodhi në votim rendin e ditës, dhe kaloi me vota unanime.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Bekim Lestrani, hodhi në votim pikën 1. Procesverbali i mbledhjes së Komitetit për Politikë dhe Financa i dt. 18.10.2024. vërejteje sugjerime nuk pati dhe pika e parë e rendit të ditës kaloni në mënyrë unanime.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Bekim Lestrani, hapi për diskutim pikën 2. Propozim vendim për shfuqizimin e vendimit për transfere të mjeteve financiare subvencione dhe transfere me nr. 02-400/01-47954 dt. 30.09.2024.

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci- kemi pasur një propozim vendim në mbledhjen e jashtëzakonshme e kemi ndryshuar 400 mijë euro edhe për këtë arsye duhet me shfuqizuar edhe ky i fundit mbetet në fuqi .

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Bekim Lestrani, rekomandon për kuvend pikën e dytë të rendit të ditës me vota unanime.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Bekim Lestrani, hapi për diskutim pikën 3. Propozim vendim për shfuqizimin e vendimit për ndryshimin e emrit të projektit me nr. 02-400/01-46220 dt. 19.09.2024.

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci- ky vendim është kur e kemi vendos në pip një investim që ka pas me u bërë në oborret e shkollave në, pip ka qenë në një shkollë tjetër ndërsa investimi është bërë në një shkollë tjetër na kanë jep disa sugjerime kemi kërkuar përmes vendimit me na lejuar ministria nuk na ka lejuar edhe ne duhet me shfuqizuar.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Bekim Lestrani, hodhi në votim pikën 3. Propozim vendim për shfuqizimin e vendimit për ndryshimin e emrit të projektit me nr. 02-400/01-46220, edhe kjo pikë rekomandohet për kuvend në mënyrë unanime .

Mbledhja përfundoi në ora 10:20 minuta

Procesmbajtëse:



Fakete Hoti



Kryesuesi i Kuvendit Komunal



Bekim Lestrani